



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kabineti i Kryetarit të Komunës së Prizrenit
Drejtoria për Ekonomi e Financa
Datë: 18 Maj 2021
Prizren

DËGJIMI I DYTË PUBLIK PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE
(KAB) 2022-2024
ME TEMË “TAKIM ME QYTETARË”

P R O C E S V E R B A L

Vazhdojmë më dëgjimin e dytë publik për pranimin e propozimeve dhe kërkesave të qytetarëve lidhur me projektet dhe shërbimet komunale për vitet në vijim!

Komuna e Prizrenit organizon katër dëgjime publike lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024.

Në këto dëgjime mëtojmë të marrim opinionin e qytetarëve për projektet vijuese të komunës sonë, shërbimet komunale dhe kërkesat tjera eventuale.

Për shkak të situatës pandemike, pjesëmarrja në këto takime do të jetë e kufizuar, sipas distancës dhe hapësirës në sallë, si dhe rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publik.

Për të mundësuar sa më shumë pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje, Komuna e Prizrenit këto dëgjime publike do t'i organizojë edhe në formën “online” përmes aplikacionit ZOOM, nëpërmjet linkut:

<https://us02ëeb.zoom.us/j/82274197275>

Meeting ID: 822 7419 7275

Më 18 maj (e martë), në ora 13:00 në sallën e Kuvendit të Komunës, do të mbahet dëgjimi i dytë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2022-2024.

Tema e këtij dëgjimi publik është **“Takimi me qytetarë”**.

Informacione shtesë në lidhje me dëgjimet publike dhe linqet për pjesëmarrje nëpërmjet platformës ZOOM mund të gjeni në:

Për gjuhëen shqipe: <https://kk.rks-gov.net/.../04/Degjime-publike-KAB.pdf...>

Për gjuhën turke: <https://kk.rks-gov.net/.../26/2021/04/ORTA-VADELI-KAB.pdf...>

Për gjuhën srb/bosh.: <https://kk.rks-gov.net/.../JAVNE-DEBATE-O-SREDNJOROCNOM...>

Qytetarët dhe të tjerët të interesuar, informacione më të përimtuara për dëgjimet publike, linqet për pjesëmarrje përmes platformës ZOOM, orën dhe ditën e mbajtjes së dëgjimeve, në të gjitha gjuhët zyrtare i kemi bërë publike kohë më parë, në Ueb faqe të komunës, Facebook, Instagram, YouTybe, TV- lokale, Radio Lokale, etj...

Të ftuar:

- Përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës së Prizrenit,
- Qytetarët,
- Organizatat Ndërkombëtare,
- Përfaqësuesit e OJQ-ve të Komunës së Prizrenit,
- Përfaqësuesit e shoqatave të bizneseve të Komunës së Prizrenit,
- Mediet lokale të Komunës së Prizrenit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Cila është kërkesa juaj për **Komunën ?**

Komuna e Prizrenit organizon dëgjime publike lidhur me
Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024.

Në këto dëgjime ftohen:

- Përfaqësuesit e Kuvendit të Komunës së Prizrenit,
- Qytetarët,
- Organizatat Ndërkombëtare,
- Përfaqësuesit e OJQ-ve të Komunës së Prizrenit,
- Përfaqësuesit e shoqatave të bizneseve të Komunës së Prizrenit,
- Mediat lokale të Komunës së Prizrenit.



Për shkak të situatës pandemike, pjesëmarrja në këto takime do të jetë e kufizuar.
Për të mundësuar sa më shumë pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje, Komuna e Prizrenit këto
dëgjime publike do t'i organizojë edhe në formën "online" përmes aplikacionit ZOOM.
Agjenden e dëgjimeve mund ta gjeni në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/prizren/>

Dëgjimin e dytë publik me qytetarët, po ashtu, e moderoi drejtoresha për Ekonomi e Financa znj. Leonora Çerreti, e cila fillimisht prezantoi planifikimet dhe parashikimet buxhetore të komunës sonë për vitin 2022.

Buxheti për vitin 2022 do të jetë 49.455.755.00 euro, %, rritje krahasuar më vitin paraprak.

Linku i prezantimit: <https://www.youtube.com/watch?v=bcv3DBTGo3Y>

Pas prezantimit të planifikimit të buxhetit për vitin vijues, drejtoresha znj. Leonorë Çerreti hapi diskutimin më të pranishmit në sallë dhe ata të cilët përcillnin debatin online.

Bujar Pulaj nga fshati Vermicë,

Vlerësoj se kërkesat tona nuk po përfillen sa duhet nga komuna, ne Vermicë, nuk ka asnjë investim ende. Kemi takuar kryetarin Haskuka, po ende nuk ka investime. Pastrimi i liqenit në fshatin tonë është problem i madh dhe propozoj që të bëhet një zgjidhje nga komuna për pastrim të shtratit të liqenit.

Për investime në të ardhmen kemi nevojë: Të rregullohet ndriçimi publik në rrugë, jemi zone kufitare dhe do të rritej siguria.

Ndërtimin e një rruge pyjore, kemi kërkuar edhe nga pylltaria që të na ndihmojë për këtë projekt, por deri tani nuk kemi përgjigje.

Rregullimi i nyjeve sanitare në shkollë edhe rregullimi i oborrit të shkollës.

Edhe disa rrugë në fshat duhet të shtrohen me kupëza betoni.

Xhemile Vezgishi

Sa i përket nyjeve sanitare në Vermicë, atje e kemi rregulluar totalisht shkollën dhe se shpejt do të rregullojmë edhe oborrin e shkollës, përndryshe shkolla është rinovuar në tërësi.

Bujar Pulaj:

Rregullimi i shkollës është bërë në fshatin Dobrusht e jo në Vermicë. Jam në cilësinë e kryetarit BL-së, Vermice në këtë dëgjim.

Erina:

Përshëndetje unë jetoj në lagjen Dardania 2, Lagje e urbanizuar në nuk kemi Ujë, Kanalizim, kemi pluhur katastrofë, qentë endacak, pa ndriçimi. Siguria e fëmijëve në rrezik. Me çfarë kriteri bëhen prioritetet ?

Kryetari i komunës, Prof. Dr. Mytaher Haskuka:

Falënderoj qytetaret e pranishëm dhe ata online që po ndjekin debatin: Per Vermicë, kërkesë konkrete kemi vetëm për ndriçim publik dhe nëse keni kërkesa tjera do shikojmë mundësitë tona buxhetore dhe sigurisht se do vijmë edhe me projekte tjera..

Sa i përket pandemisë dhe pasojave ne biznese, ne kemi ndare dhe shpërndarë një buxhet mbi 700.000 euro, edhe në të ardhmen do i shohim se çka mund të bëjmë për të ndihmuar këtë sektor.

Në rajonin e Vermicës kemi investuar dhe jemi në ndërtim të një stadiumi modern. Nuk është e vërtetë që nuk ka asnjë investim në ato fshatra. I nderuar, ju ftoj që të jeni më specifik në kërkesa në mënyrë që ne të mund të përfshijmë projekte për realizim me buxhetin vijues.

Sa i përket shkollës do të shohim mundësitë vetjake ose me kredi na fondi për efikasitetin e energjisë.

Lidhur me lagjen Dardania 2, ne raste ku kemi pas mundësi kemi hapë të gjitha rrugët, kemi rritur kapacitetet e uji etj.

Për qentë endacak kemi ndare fonde dhe shpresojmë se do t'i japim zgjidhje këtij problemi.

Komuna investon vetëm në prona publike dhe i ftojmë qytetaret që t'i zgjidhin problemet e pronës në mënyrë që ne të investojmë me pas. Në dardania 2 do shohim mundësitë me KEDS, që të vendosim edhe një trafo të re.

Erza:

Kërkesa ime është se kemi shumë njerëz të sëmurë me demence, duhet të kujdeset edhe një anëtar tjetër i familjes për ta:

A do merrni masa për me i ndihmuar këto raste?

Mytaher Haskuka :

Komuna jone ofron shërbime për të moshuar shërbimin Geriatrik, ne ofron shërbime edhe për persona të shtirë – me regjim shtrati, ofrojmë shërbime terminale, sigurisht se do shohim mundësitë për rritjen e shërbimeve tjera.

Drejtorja e Shërbimeve Publike, me njofton se afër shkollës do të rregullohet trotuari dhe do rritet siguria për nxënësit e shkollës dhe qytetaret tjerë.

Pastrimin e liqenit mund të bëjmë me ndonjë aksion vullnetar përndryshe është kompetence e Ministrisë mirëmbajtja e liqenit. Do provojmë të flasim me ministrinë dhe t'i japim zgjidhje këtij problemi.

Sheshi Skënderbeu kur ka me u rregulluar?

Kemi iniciative që ta rregullojmë këtë hapësirë por për momentin është në proces gjyqësor dhe ne jemi të detyruar të presim.

Lumturie Gashi:

Përshëndetje për të gjithë unë kam një problem; komuna më ka evidentuar rrugë në parcelën time me nr. 11170-35, komuna nuk më jep leje të ndërtohet shtëpi

Sibel Veçaj:

Zonjës i kthejmë përgjigje me shkrim

Vitor Tushaj:

Përshëndetje, E kam të pamundur të flas për paraqes një kërkesë me shkrim. Ka të bëjë me shkollën fillore " Pjeter Budi " paralelja në Dedaj!

Xhemile Vesgishi:

Po shkolla është paralele e shkollës "Pjeter Budi", do t'i marrim kërkesat e tyre në DKA, ka disa projekte dhe në këto projekte kemi edhe rregullimin e oborreve. Do shkojmë për vizitë në këtë shkollë dhe do vlerësojmë nevojat.

Eroll Shabani :

Jam banor i fshatit Skorobisht; Rruga skorobisht – Lubizhde është e atakuar nga deponitë ilegale. Nuk fajësoj inspektoret apo komunën por kërkoj që bashkë të organizojmë fushatë sensibilizuese për ruajtjen e mjedisit. Shqetësimi i dytë mos shenjëzimi i rrugës Skorobishtë-Lubizhdë

Mytaher Haskuka:

Për fshatin Skorobishtë kam kërkuar nga DSHP-ë, që të kujdesen për realizim cilësor të rrugës, personalisht do ta vizitoj këtë rrugë dhe do angazhohem edhe për largimin e deponimeve ilegale. Se bashku me qytetaret mund ta mbrojmë ambientin atje.

Leonora Qerreti deri në fund të muajit pranojmë kërkesa nga kryetaret e fshatrave.

Resmije Krasniqi:

Kam tri pyetje; Kur do te shpallet thirrja publike per OJQ-të, që merren me perona më nevoja te veçanta. Pse DPMS-ë, dhe z. Islam Thaqi nuk përgjigjet per strehimin e veteranit te UÇK-së. Perse QPS dhe DPMS nuk interesohet per dy qytetar që rrinë në shoqatën “ Hader”?

Islam Thaqi:

Besoj se shumë shpejt do bëhet shpallja për subvencionim të OJQ-ve, Pyetja e dyte: arsyeya qëndron se DPMS-ë, ka lëshuar në punë shtëpinë për persona me nevoja te veçanta. Jemi te interesuar per ta bere zgjidhjen edhe per dy personat qe folët ju dhe do shohim mundësitë se si te ju ndihmojmë si komune por e kemi shume te vështirë, ngase kaq kemi mundësi buxhetore.

Mytaher Haskuka

Znj. Resmije ju kemi mbështetë sa kemi pas mundësi në të kaluarën por do shohim mundësitë edhe për këtë vit të ju mbështesim

Erina

Kur kanë mu vendos shportat per mbeturina ne qytet? Tjetra lagja “Bajrakli” nuk është investuar asgjë, janë dy shtëpi të vjetra qe paraqesin edhe rrezik për banoret dhe këmbësoret. E treta shqetësuese është parkimi i kerreve?

Kryetari M. Haskuka

Lagja “Bajrakli”, këtë vit kemi buxhet për intervenime në disa rruge dhe besoj se i zgjidhim problemet e theksuara.

Per parkingje kemi probleme per shkak te infrastrukturës se ngushtë, jemi duke punuar me disa ekspert për këtë problem dhe besoj se do intervenojmë në të gjitha rrugicat e qytetit

Kemi 16 projekte per urat e Prizrenit dhe brigjet e lumëbardhit dhe në këtë projekt është i përfshirë dhe problemi i parkingjeve.

Për shtëpitë e vjetra komuna çdo vit intervenon në dy apo tri shtëpi, buxheti është pengesë në zgjidhjen e këtij problemi, nuk kemi fond te mjaftueshme per restaurimin e tyre.

Do flasim edhe qeverinë e Kosovës dhe te shohim se si do mund t'i mbrojmë këto shtëpi.

Me harte zonale kemi parapare zgjerim të rrugëve ne disa raste. Analiza e mobilitetit të rrugëve është bërë dhe së bashku me policinë do t'i shohim edhe kahet e trafikut ne qytet.

Sibel Vezaj:

Për shporta jemi duke punuar dhe po shohim ku di t'i vendosim, besojmë se së shpejti do vendosen shportat në qytet.

Leonora Çerreti

Faleminderit të nderuar qytetarë dhe ju të pranishëm tjerë.